



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 98, datë 30.03.2023

PËR
VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË OBJEKTIT
PALESTRA E SHKOLLËS 9-VJECARE "14 NËNTORI", DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore"; Raportit teknik/Analizës Strukturore hartuar nga subjektet "NET-GROUP shpk & STUDIOARCH 4" me nr. 5433 prot, datë 17.01.2023, protokolluar pranë Bashkisë Durrës me nr. 663 prot, datë 18.01.2023 dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :



1. Vijimin e procedurës së prishjes së detyruar të objektit palestra e shkollës 9-vjecare "14 Nëntori", Durrës.
2. Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e

dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të akteve ligjore në fuqi.

3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve të zonës dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative Nr.5, Durrës.
5. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, Drejtoria e Kabinetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare dhe Njësia Administrative Nr.5, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 31.03.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 220/prot.
4

Durrës, më 31.03.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.98 datë 30.03.2023 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të objektit palestra e shkollës 9-vjecare “14 Nëntori”, DURRËS

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI



